

# PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN  
FINANCIAR TË KOSOVËS

## FONDI PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE TË KOSOVËS

# PERIODIKU BANKAR



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 Banka Ekonomike



 BPB

 iSBANK

 NLB Banka

 ProCredit Bank

 Raiffeisen  
BANK



 ZiraatBank

PËRGATITUR NGA:

DR. SC. PETRIT BALIJA,  
Kryeredaktor

KRESHNIK KOSUMI,  
Redaktor

MIRANDA RUGOVAJ  
Koordinatore

MITHAT SEJDIU  
Dizajn

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,  
Shtator 2016



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Deklarata e autorësisë: Materiali në këtë publikim ka të drejta autoriale. Kopjimi apo përdorimi i një pjese apo i tërë publikimit pa leje apo pa shënuar burimin e informacionit mund të konsiderohet shkelje e ligjeve në fuqi.

# FONDI PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE TË KOSOVËS

---

## PËRMBAJTJA

### PJESA I

1. Hyrje në Sigurimin e Depozitave **1**
2. Sistemi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë **1-2**
3. Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë **2**
  - Anëtarët **2**
  - Limiti i Sigurimit të Depozitave **2**
4. Të dhënat kryesore dhe treguesit **3**
  - Depozitat e siguruara **3**
5. Mekanizmi i Financimit **6**
  - Kapitalizimin fillestar i FSD **6**
  - Sistemi diferencues i premieeve **6**
  - Normat vjetore të premiumit **6**
  - Bilanci i FSD-së dhe struktura **6**
  - Madhësia e synuar e FSD **6**
6. Menaxhimi i Investimeve **9**
  - 2011-2015 Treguesit kryesor pesëvjeçarë të sigurimit të depozitave **10**

### PJESA II

- Indikatorët kryesorë të industrisë bankare të paraqitura në numra dhe figura **13**
- Struktura e asetëve **13**
  - Struktura e detyrimeve **14**
  - Të hyrat dhe shpenzimet **16**
  - Norma efektive e interesit në kredi dhe depozita **19**
  - Kreditë jo-performuese **19**

### PJESA III

- Lajme nga industria bankare dhe ekonomia **23-25**

# I.

## FONDI PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE TË KOSOVËS

### Hyrje në sigurimin e depozitave

Sistemet e sigurimit të depozitave janë një nga katër shtyllat kryesore të rrjetit të sigurisë financiare, së bashku me rregullativën prudenciale dhe mbikëqyrjen efektive, kreditorin i instancës së fundit dhe mekanizmat efektiv të zgjidhjes së bankave.

#### PËRKUFIZIMET KRYESORE TERMINOLOGJIKE

“Sistem i sigurimit të depozitave” i referohet siguruesit të depozitave dhe relacionet e tij me pjesëmarrësit e rrjetit të sigurisë financiare në mbështetje të funksioneve të sigurimit të depozitave dhe proceseve të zgjidhjes së bankave.

**Burimi:** Principet Themelore për Sistemet Efektive të Sigurimit të Depozitave, të publikuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Siguruesve të Depozitave <http://www.iadi.org/en/assets/File/Core%20Principles/cprevised2014nov.pdf>



Figura 1: Katër Shtyllat e rrjetit të sigurisë të Stabilitetit Financiar

### Sistemi i sigurimit të depozitave në Kosovë

Sistemi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë (SSD) është themeluar me Qëllim të Politikës Publike të mbrojtjes së depozitorëve të vegjël dhe mbështetjes së stabilitetit financiar.

E iniciuar nga Banka Qendrore dhe me efektivitet ne maj te vitit 2011, SSD është themeluar si projekt zhvillimor në kuadër të bashkëpunimit bilateral ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë me një kapital fillestar prej € 17.5 milionë.

E drejta e autorësisë: Pjesa e parë e këtij publikimi është shkrim i Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë publikim pasqyrojnë pikëpamjet dhe të dhënat e këtij institucioni.

**TIPARET KRYESORE DHE KARAKTERISTIKAT**

Organizim institucional i siguruesit të depozitave	Institucion i pavarur publik me autonomi operacionale dhe administrative nga strukturat e qeverisë dhe shërbimit civil.
Anëtarësia	Anëtarësia e detyrueshme për bankat e licencuara për të pranuar depozita (dhe për degët e bankave të huaja ku vendi amë nuk ofron sigurim të depozitave ose ofron me limit të sigurimit më të ulët sesa e përshkruar në Ligj)
Mandati	Kompensim të depozitorëve të siguruara ("Pay-box")
Limiti i sigurimit të Depozitave	EUR 4,000 (i tashëm) EUR 5,000 (01.01.2018)
Mbulueshmëria e sigurimit	Personat fizik (individët) dhe, Personat juridik (kompani të regjistruara, etj.)
Rregulla e sigurimit të depozitave	Sigurimi vlen për çdo depozitor dhe për cdo bankë anëtare
Llojet e depozitave të siguruara	Llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimeve, depozitat me afat, etj. Depozitat në euro dhe në valuta të huaja janë të siguruara por pagesat e kompensimit bëhen në euro
Kategoritë e përjashtuara	Depozitat e bankave dhe institucioneve financiare, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, qeverisë qendrore dhe lokale dhe autoriteteve administrative, depozitat e mbajtura në degët e institucioneve financiare të Kosovës që operojnë jashtë vendit
Mekanizmi i financimit	Sistem i financuar "paraprakisht" ("ex-ante"), kryesisht nga mbledhja e premieeve të sigurimit të depozitave të paguara nga bankat anëtare në baza tre-mujore
Sistemi i Premieeve	Sistemin diferencues të premieeve i bazuar në ekzaminime të BQK-së
Nivelin i synuar i Fondit	9% të gjithësej shumës së depozitave të siguruara

## Fondi i sigurimit të depozitave në Kosovë

Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë "FSDK" është institucion i pavarur publik i themeluar në vitin 2011 në bazë të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë për të mbrojtur depozitorët e vegjël dhe për të mbështetur stabilitetin financiar.

FSDK raporton Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës "BQK" dhe qeveriset nga Bordi Menaxhues.

FSDK ka autoritetet:

1. caktim dhe arkëtim të premive të sigurimit;
2. investim të Fondeve për Sigurim të Depozitave;
3. bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës për shkëmbim të informacionit;
4. në bashkëpunim me BQK, merr pjesë me fonde, në zgjidhje të ndonjë banke anëtare në rast të transferimit të detyrimeve të siguruara;
5. huamarrje në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve;
6. miratimi i legjislacionit sekondar dhe sanksioneve administrative.

Për të siguruar përmbushjen efikase të mandatit, FSDK bashkëpunon ngushtë me BQK-në, si rregullator, mbikëqyrës dhe autoritet i zgjidhjes. Bashkëpunimi në mes të FSDK-së dhe BQK-së është detajuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, duke siguruar kornizë për shkëmbim të informacionit dhe bashkëpunimit.

### PËRKUFIZIMET KRYESORE TERMINOLOGJIKE

"Mandati" i siguruesit të depozitave referohet një sërë udhëzimeve zyrtare që përshkruan rolet dhe përgjegjësitë e tij

- Mandati "pay box" ku siguruesi depozitave është përgjegjës vetëm për rimbursimin e depozitave të siguruara;
- Mandati, "pay box plus" ku siguruesi i depozitave ka përgjegjësi shtesë, të tilla si funksione të caktuara për zgjidhjen e bankave (p.sh. mbështetje financiare);
- Mandati, "loss minimiser" ", ku siguruesi angazhohet në mënyrë aktive në një përzgjedhje nga një sërë strategjive të zgjidhjes së bankave me kosto më të ulët; dhe
- Mandati, "risk minimiser" ku siguruesi ka mandate të zgjeruar më funksione të plota për minimizimin e rrezikut që përfshijnë vlerësimin e rrezikut / menaxhimit, si dhe instrumente të ndërhyrjes dhe të zgjidhjes së hershme të bankave, dhe në disa raste përgjegjësitë pruduenciale mbikëqyrëse.

*Burimi: Principet Themelore për Sistemet Efektive të Sigurimit të Depozitave, të publikuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Siguruesve të Depozitave <http://www.iadi.org/en/assets/File/Core%20Principles/cprevised-2014nov.pdf>*



## Anëtarët

Më 30 qershor 2016, anëtarësia e FSDK-së përfshinë nëntë banka të licencuara për të pranuar depozita në Kosovë. Anëtarësia në FSDK është automatike me rastin e licencimit nga BQK dhe e detyrueshme në përputhje me Ligjin. Një degë e bankës së huaj e licencuar për të pranuar depozita në Kosovë, është e obliguar që të bëhet anëtare e FSDK-së vetëm nëse vendi amë ofron sigurim të depozitave me mbulesë më të ulët sesa e përshkruar në Ligj.

**TABELA 1. ANËTARËT E FSDK-SË**

Nr.	Bankat anëtare të FSDK-së (më 30 qershor 2016)
1.	Banka Ekonomike
2.	Banka Kombëtare Tregtare, Dega në Kosovë
3.	Banka për Biznes
4.	NLB Prishtina
5.	ProCredit Bank Kosovë
6.	Raiffeisen Bank Kosovë
7.	TEB SH.A.
8.	Turkiye Is Bankasi, Dega në Kosovë
9.	Ziraat Bankasi, Dega në Kosovë

## Limiti i sigurimit të depozitave

Aktualisht, limiti i sigurimit të depozitave është €4,000 i cili është rritur gjatë pesë viteve të fundit nga €2,000. Limiti i sigurimit të depozitave do të rritet në €5,000 efektive nga 1 janari 2018.

**TABELA 2. RRRITJA E LIMITIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**

Limiti i sigurimit të depozitave	Shuma në Euro
2011	2,000
2012	2,000
2013	2,000
2014	3,000
2015	3,000
2016	4,000
2018	5,000

## Të dhënat kryesore dhe treguesit

### Depozitat e siguruara

Numri i depozitorëve të siguruar depozitat e të cilëve janë të mbuluara deri në limitin e e sigurimit të depozitave në raport me numrin e përgjithshëm të depozituesve qëndroi në 97.3% në fund të tremujorit të dytë të vitit 2016, i cili ka treguar një përmirësim për 33 pikë bazë nga 97.0% në fund të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (Tabela 3) . Vëllimi i përgjithshëm i depozitave të siguruara arritën vlerën prej € 587 milion euro në fund të tremujorit të dytë në vitin 2016 ose 22.3% të shumës totale të depozitave të bankave anëtare në krahasim me 18.5% në fund të tremujorit të dytë të vitit të kaluar. Totali i depozitave të siguruara u rrit me afro 25% ose për € 118.6 milionë krahasuar me periudhë njëjtë të vitit të kaluar.

**TABELA 3. TREGUESIT KRYESORË TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**

<b>Të dhëna kumulative për të gjitha bankat anëtare</b> Limiti i Sigurimit të Depozitave EUR 4,000	30/06/2016	30/06/2015	<b>Ndryshimi në %</b>
Gjithsej depozitues (numri)	908,101	840,653	+8.0%
Depozituesit e siguruar (numri)	883,500	815,130	+8.4%
në % të totalit	97.3%	97.0%	33bp
Totali i depozitave (në '000 euro)	2,635,968	2,533,343	+4.1%
Depozitat e siguruara (në '000 euro)	587,428	468,826	+25.3%
në % të totalit	22.3%	18.5%	378bp

Numri i përgjithshëm i depozituesve të siguruar depozitat e të cilëve janë të mbuluara plotësisht deri në limitin e e sigurimit të depozitave ishte në rreth 87.9% (Tabela 4), që do të thotë se 798 mijë depozituesve të siguruar kanë depozita deri në 4,000 euro (përbëjnë rreth 42% të vëllimit të përgjithshëm të siguruar të depozitave, Grafiku 2). Përderisa pjesa e mbetur, 9.3% %, apo 84 mijë e depozituesve të siguruar kanë depozita apo kërkesa neto më shumë se 4,000 euro (që përbëjnë 58% të vëllimit përgjithshëm të siguruar të depozitave, Grafiku 2). Numri i depozituesve të pranueshëm të cilët kanë detyrime të vonuara më të madhe se totali bruto i depozitave ishte 23 mijë ose 2.6%.

**TABELA 4. DEPOZITUESIT E SIGURUAR KARSHI ATYRE TË PASIGURUAR (STRUKTURA)**

<b>Të dhëna kumulative për të gjitha bankat anëtare</b> Limiti i Sigurimit të Depozitave EUR 4,000	<b>30/06/2016</b>	
Depozituesit e siguruar me kërkesa neto deri në nivelin e sigurimit: kërkesat neto <= 4000 EUR	798,866	87.97%
Depozituesit e siguruar me kërkesa neto mbi në nivelin e sigurimit: kërkesat neto <= 4000 EUR	84,634	9.32%
Depozituesit e përjashtuar	610	0.07%
Depozituesit e pranueshëm me detyrime të vonuara më të mëdha sesa depozitat bruto	23,991	2.64%
<b>Numri i përgjithshëm i depozituesve</b>	<b>908,101</b>	<b>100%</b>

Shuma e depozitave që janë përjashtuar me ligj nga mbulueshmëria e sigurimit të depozitave në arritën në 119 miliona euro deri më 30 qershor 2016 apo 5% e totalit të depozitave të bankave anëtare (Grafiku 1).

<sup>1</sup> Neni 5 i LSD-së i ndryshuar në Nenin 3 paragrafi 1; nën-paragrafi 1.3, neto shuma aplikohet ku nga shuma totale e llogarive të depozituesve të pranueshëm zbriten detyrimet e vonuara të depozituesit ndaj bankës dhe shuma e mbetur rimbursohet deri në nivelin maksimal të siguruar (d.m.th. niveli i sigurimit).




Figura 2: Struktura e depozitave

Tabela 5 tregon strukturën e depozituesve të siguruara për kah personat fizik dhe juridik. Përqindja e personave fizikë me kërkesat neto më pak ose barabartë me limitin e e sigurimit të depozitave në 4,000 euro është 94.2% me totalin e neto kërkesave në vlerën prej 234 milionë euro që janë të siguruara plotësisht, ndërsa 5.8% janë persona juridikë me totalin e neto kërkesave në 14.4 milion euro që janë të siguar plotësisht gjithashtu . Përqindja e personave fizikë me neto kërkesat më të madhe se limiti i sigurimit të depozitave është 78.9% me totalin e neto kërkesave në vlerën prej 1.7 miliardë euro të cilat janë të siguruara deri në limitin e sigurimit të depozitave në 4,000 euro, ndërsa 21.1% e depozituesve në këtë kategori janë personat juridik me shumën totale të neto kërkesave në vlerën prej 476 milionë euro. Shuma totale e neto kërkesave mbi limitin e sigurimit të depozitave për personat fizik dhe juridik arritën në vlerën 2.2 miliardë euro nga të cilat 339 milionë euro të siguruara (Grafiku 2).

TABELA 5. STRUKTURA E DEPOZITUESVE TË SIGURUAR, PËR NGA SUBJEKTI				
Të dhëna kumulative për të gjitha institucionet anëtare	Nr. i depozituesve	në %	Kërkesat neto në '000 euro	në %
<b>Totali i siguar &lt;= 4,000 euro, prej të cilave</b>	<b>798,866</b>	<b>100%</b>	<b>248,892</b>	<b>100%</b>
Totali i personave fizik	760,166	95.2%	234,394	94.2%
Totali i personave juridik	38,700	4.8%	14,498	5.8%
<b>Totali i siguar &gt; 4,000 euro, prej të cilave</b>	<b>84,634</b>	<b>100%</b>	<b>2,258,456</b>	<b>100%</b>
Totali i personave fizik	77,182	91.2%	1,781,593	78.9%
Totali i personave juridik	7,452	8.8%	476,863	21.1%
<b>Gjithsej</b>	<b>883,500</b>			



### Struktura e depozitave të siguruara (Limiti i Sigurimit të Depozitave EUR 4,000) Shuma në Euro




Figura 3: Struktura e depozitave të siguruara

## Mekanizmi i financimit

SSD është e financiar ‘ex-ante’ ku fondi për sigurimin e depozitave (FSD) financohet kryesisht përmes arkëtimit të premieeve të vazhdueshëm nga bankat anëtare dhe kthimet nga investimet të gjeneruara nga aktivitetet investuese.

### Kapitalizimin fillestar i FSD

Kapitalizimi fillestar për FSD-në është dhënë nga kontributet në kapital nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë së Financave (MF) dhe Qeverisë Federale Gjermane (përmes KfË).

#### PËRKUFIZIMET KRYESORE TERMINOLOGJIKE

“Financimi paraprak ex ante” i referohet mbledhjes së rregullt të premieeve, me qëllim që të akumulojnë një fond për të përmbushur detyrimet e ardhshme (psh rimbursimin e depozituesve) dhe të mbuluar kostot operacionale të siguruesit të depozitave.

“Financimi ex post” i referohet sistemeve në të cilat fondet për të mbuluar detyrimet e sigurimit të depozitave mbledhen vetëm nga bankat mbijetuara, pas falimentimit të një banke.

*Burimi: Principet Themelore për Sistemet Efektive të Sigurimit të Depozitave, të publikuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Siguruesve të Depozitave <http://www.iasi.org/en/assets/File/Core%20Principles/cprevised-2014nov.pdf>*

TABELA 6. KONTRIBUTI I KAPITALIT NË FSD, NË VITE

Kontributi i Kapitalit në FSD në vite	Qeveria e Republikës së Kosovës (përmes Ministrisë së Financave)	Financimi nga IDA (përmes Bankës Botërore)	Qeveria Gjermane (përmes KfË)
2011	3,300,000		4,500,000
2012	3,300,000		0
2012	2,957,511	Financimi i pagesës së 3-të	0
2013	1,442,489		2,000,000
Total	11,000,000		6,500,000
në % të totalit	22.3%	18.5%	378bp

## Sistemi diferencues i premieeve

FSDK-ja vlerëson premiumet diferenciale ndërmjet bankate anetare për ta dalluar nivelin e rrezikut në bazë të ekzaminimit të BQK-së për secilën bankë. Bankat anëtare paguajnë premiumet e sigurimit në nivel proporcional me rrezikun e tyre relativ ndaj fondit të sigurimit të depozitave, dmth, premium më i lartë për anëtarët me profilin me të lartë të rrezikut.

Premiumi kalkulohet në bazë të mesatares së bilancit fillestar dhe perfundimtar të depozitave të siguruara për periudhën kontabël tremujore, për të siguruar zvogëlimin e efektit sezonal.

## Normat vjetore të premiumit

Tabela 7 tregon nivelin e normave të premiumit të vazhdueshëm. Bankat anëtare me rangim më të lartë (Klasa 1) sipas vlerësimit të bazuar në ekzaminimin e BQK-së, (që paraqesin rrezik më të ulët), paguajnë 0.45% në vit të shumës totale të depozitave të siguruara, ndërsa bankat me rangim më të ulët, (që paraqesin rrezik më të lartë), do të paguanin 1.50% në vit të shumës totale të depozitave të siguruara.

### MË SHUMË INFORMACION

Sistemet me premie diferenciale ose të bazuar në vlerësim në rrezikut të bankave kontribuojnë në minimizimin e çështjes së "riskut moral" ("moral hazard"), duke ofruar stimuj financiar për bankat anëtare të jenë më të kujdesshme në menaxhimin e rrezikut dhe minimizimit të subvencionimit të tërthortë midis bankave anëtare, që është në përputhje me Principet Themelore për Sistemet Efektive të Sigurimit të Depozitave, të publikuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Siguruesve të Depozitave. Gjithashtu, Direktiva e re Evropiane e Komisionit të BE-së për skemat e garantimit të depozitave e miratuar nga Parlamenti Europian në prill të vitit 2014, ka bërë të detyrueshëm harmonizimi i mekanizmave të financimit të SSD, dhe implementimi e kontributeve nga bankat të bazuar në rrezik.

*Burimi: Principet Themelore për Sistemet Efektive të Sigurimit të Depozitave, të publikuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Siguruesve të Depozitave <http://www.iadi.org/en/assets/File/Core%20Principles/cprevised2014nov.pdf>*

*DIRECTIVE 2014/49/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 16 April 2014 on deposit guarantee schemes (recast), <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0049&from=EN>*

**TABELA 7. NORMAT VJETORE TË PREMIUMIT**

KATEGORIA E PREMIUMIT (EKZAMINIMI NGA BQK)	Normat nominale të premiumit p.a. (2011-2015)	Normat nominale të premiumit p.a. 2016 e tutje
Klasa 1	0.30%	0.45%
Klasa 2	0.50%	0.65%
Klasa 3	0.75%	0.90%
Klasa 4	1.00%	1.15%
Klasa 5	1.50%	1.50%

## Bilanci i FSD-së dhe struktura

Më 30 qershor, 2016 bilanci i përgjithshëm i FSD-së ishte 28.7 milion euro nga të cilat 17.5 milion euro kontribute me kapital dhe 11.2 euro surpluse të akumuluar (Tabela 8). Pjesa e kontributeve të bankave anëtare në bilancin e përgjithshëm të FSD-së ka arritur nivelin prej 39 % (Grafiku 3).




Figura 4: Struktura e burimeve të FSD-së

### Madhësia e synuar e FSD

Në vitin 2013, FSDK ka miratuar kornizën për të përcaktuar nivelin e rezervës së FSD-së e cila synohet të akumulohet gjatë përdhës së përcaktuar kohore për të mundësuar përmbushjen e mandatit. Madhësia e synuar e FSD-së është vendosur në limitin në mes 8 dhe 9% (niveli më i ulët dhe më i lartë), dhe përfaqësohet si përqindje e totalit të depozitave të siguruara (TDS).

Më 30 qershor, 2016 raporti i mbulueshmërisë i FSD-së si përqindje e totalit të depozitave ishte 4.89 %, krahasuar me 5.27% për qind në tremujorin e dytë të 2015.

### Burimet e financimit për kërkesat e likuiditetit

Në rast se fondi për sigurimin e depozitave shfrytëzohet tërësisht ose ka mungesë të fondeve të mjaftueshme për ta përmbushur mandatin, FSDK mund t'i ngarkojë bankat me premie emergjente, deri në dy (2) here, i nivelit të premiebre brenda një (1) viti. Përveç kësaj, ligji lejon FSDK për të marrë hua nga tregu, por jo nga bankat anëtare, me garanci nga qeveria dhe të lëshojë fletë-obligacione.

Më 30 qershor, 2016, totali i fondeve likuide në dispozicion që përbën bilancin e FSD-së prej 28.7 milion euro dhe 10 milion euro linjë kreditore, arriti në gjithsej 38.7 milion euro (Tabela 8). Raporti i likuiditetit ishte 6.60 % më 30 qershor, 2016, në krahasim me 7.41 % në tremujorin e dytë të 2015.

TABELA 8. TOTAL FONDET DHE RAPORTI I MBULUESHMËRISË

Shumat në '000 euro	30/06/2016	30/06/2015	Ndryshimi në %
Total depozitat e siguruar (TDS)	587,428	468,826	25.3%
Fondi i sigurimit të depozitave (FSD)	28,749	24,717	16.3%
Linja kreditore 'standby'	10,000	10,000	0.0%
Totali fonde	38,749	34,717	11.6%
Norma e mbulimit (FSD / TDS)	4.89%	5.27%	-38bp
Raporti i likuiditetit (Totali fonde / TDS)	6.60%	7.41%	-81bp
Madhësia e synuar	9.00%	9.00%	

## Menaxhimi i investimeve

Korniza ligjore e investimeve e FSD-së është e rregulluar në mënyrë strikte me ligj, duke theksuar principet e sigurisë dhe likuiditetit mbi kthimin për të siguruar përmbushjen e mandatit për të kompensuar sa më shpejtë depozituesit e siguruar. Udhëzimet e Investimeve përcaktojnë politikën e investimeve dhe kriteret për investime të FSD-së që duhet ndjekur në çdo vit afarist të miratuar nga Bordi Menaxhues.




Figura 5: Principet e investimeve

## 2011-2015 treguesit kryesor pesëvjeçar të sigurimit të depozitave

**TABELA 9.**

Treguesit kryesore më 31 dhjetor	2015	2014	2013	2012	2011
	(shuma është dhënë në '000 EUR, përveç limitit të sigurimit)				
GJITHSEJ ANËTARË	9	8	8	8	7
LIMITI I SIGURIMIT	3,000	3,000	2,000	2,000	2,000
DEPOZITAT E SIGURUARA	494,712	452,263	423,810	321,462	299,993
FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE	26,920	24,717	22,688	17,391	9,097
RAPORTI I MBULUESHMËRISË	5.4%	5.5%	5.4%	5.4%	3.0%
RAPORTI I SYNUAR	9.0%	9.0%	9.0%	5.0%	5.0%




Figura 6: Limiti i Sigurimit të Depozitave




Figura 7: Gjithsej Banka Anëtare




Figura 8: Gjithsej Depozita të Siguruara






Figura 9: Fondi i Sigurimit të Depozitave




Figura 10: Raporti i FSD

## II. INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRIËS BANKARE

### Struktura e asetëve

STRUKTURA E ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010-2016) (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qer-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.2	433.2
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.7	316.0	285.7
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.5	453.1
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,019.4	2,173.5
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.3	56.5
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	27.9	29.8	30.0
<b>Gjithsej Asete</b>	<b>2,455.1</b>	<b>2,649.7</b>	<b>2,829.3</b>	<b>3,059.3</b>	<b>3,185.6</b>	<b>3,387.3</b>	<b>3,432.1</b>

Tab. 10 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

PËRBËRJA E STRUKTURES SË ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010 -2016) (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qer-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.5%	12.5%	15.0%	15.1%	14.0%	14.5%	12.6%
Bilanci me bankat komerciale	17.9%	12.4%	10.2%	11.1%	12.3%	9.3%	8.3%
Letrat me vlerë	7.1%	7.6%	9.1%	11.6%	12.0%	14.0%	13.2%
Kreditë dhe lizingu	59.4%	64.1%	62.3%	59.0%	59.1%	59.6%	63.3%
Asetet fikse	1.8%	1.8%	2.0%	1.8%	1.7%	1.7%	1.6%
Asetet tjera	1.3%	1.6%	1.3%	1.3%	0.9%	0.9%	0.9%
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Tab. 11 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese




Fig. 11 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010 - 2016)											
(milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4
Qer-2016	56.4	27.8	167.6	21.7	101.3	731.1	47.5	22.0	101.1	132.0	1,408.5

Tab. 12 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

PJESËMARRJA E KREDIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010-2016)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	3.7%	1.4%	12.5%	1.8%	10.7%	51.0%	3.9%	1.9%	2.2%	11.1%	100.0%
2011	3.5%	1.5%	11.9%	1.3%	10.1%	52.7%	3.5%	2.0%	4.8%	8.7%	100.0%
2012	3.7%	1.4%	11.1%	1.3%	10.5%	53.2%	3.2%	1.9%	4.6%	9.1%	100.0%
2013	3.8%	1.7%	10.8%	1.7%	9.8%	52.6%	4.0%	1.6%	5.6%	8.4%	100.0%
2014	4.0%	1.6%	12.2%	1.6%	8.5%	53.7%	4.1%	1.4%	4.8%	8.1%	100.0%
2015	4.5%	1.4%	12.3%	1.3%	7.5%	51.2%	3.8%	1.6%	7.1%	9.3%	100.0%
Qer-2016	4.0%	2.0%	11.9%	1.5%	7.2%	51.9%	3.4%	1.6%	7.2%	9.4%	100.0%

Tab. 13 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

## Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIJË BANKARE (2010-2016)							
(milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qer-16
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.6	43.4	90.7
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,701.4	2,692.8
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6	18.7
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	3.1	3.4
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.2	191.2	185.7
Borxhi i ndërruar	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3	36.8	38.1
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.0	394.0	402.6
<b>Gjithsej Detyrime</b>	<b>2,455.1</b>	<b>2,649.7</b>	<b>2,829.3</b>	<b>3,059.3</b>	<b>3,185.6</b>	<b>3,387.3</b>	<b>3,432.1</b>

Tab. 14 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

**PJESËMARRJA E STRUKTURËS SË DETYRIMEVE TË INDUSTRIË BANKARE (2010-2016)**

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qer-16
Bilanci nga bankat tjera	2.9%	1.5%	0.2%	0.5%	1.0%	1.3%	2.6%
Depozitat	78.9%	79.4%	80.6%	80.1%	79.7%	79.8%	78.5%
Huatë tjera	1.0%	1.1%	0.7%	0.4%	0.4%	0.5%	0.5%
Provizionet e shlyera	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
Detyrimet tjera	6.5%	7.2%	7.8%	8.0%	7.2%	5.6%	5.4%
Borxhi i ndërvuar	1.4%	1.2%	1.1%	1.8%	1.5%	1.1%	1.1%
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.0%	0.0%	-	-	-
Mjetet vetanake	9.4%	9.5%	9.6%	9.1%	10.1%	11.6%	11.7%
<b>Gjithsej Detyrime</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Tab. 15 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese




Fig.12 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

## Të hyrat dhe shpenzimet

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (2010-2015) (milion euro)								
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	169.6	2.7	3.1	-	37.5	3.9	0.3	217.1
2011	186.3	4.1	4.2	-	41.7	3.3	0.0	239.6
2012	194.9	2.0	2.3	-	44.9	2.4	0.7	247.1
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	189.5	1.1	2.9	-	44.5	3.3	2.9	244.2
2015	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 16 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 13 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (2010-2015) (milion euro)										
Periodha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
2010	49.4	4.8	1.0	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.0	184.3
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	36.4	3.1	4.5	11.1	20.5	42.4	34.8	24.5	6.8	184.2
2015	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 17 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 14 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 15 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese



TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)								
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
Qer-2015	91.6	0.3	2.1	0.2	22.4	2.2	0.7	119.6
Qer-2016	89.4	-	-	-	22.7	1.7	-	113.7

Tab. 18 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)										
Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
Qer-2015	9.1	1.9	1.1	5.5	3.1	20.9	16.1	12.5	4.6	74.8
Qer-2016	9.5	-	-	7.9	6.3	20.9	21.2	6.1	4.2	76.0

Tab. 19 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 16 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

## Normat efektive të interesit në kredi

**NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI (2010-2016)**

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qer-16
Normat efektive në kredi të reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.21%
Normat efektive për korp. jofinanc.	14.11%	13.04%	12.34%	10.75%	9.56%	7.39%	6.75%
Normat efektive për ek.familjare	13.77%	13.85%	12.00%	11.33%	8.88%	8.39%	7.75%

Tab. 20 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar




Fig. 17 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

## Normat efektive të interesit në depozita

**DIFERENCA NDËRMJET NORMAVE TË INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA (2010-2016)**

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qer-16
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.21%
Normat efektive për gjithsej depozitat e reja	3.38%	3.62%	3.72%	2.40%	1.11%	1.15%	1.03%
<b>Diferenca</b>	<b>10.59%</b>	<b>9.68%</b>	<b>8.52%</b>	<b>8.50%</b>	<b>8.18%</b>	<b>6.54%</b>	<b>6.18%</b>

Tab. 21 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar




Fig. 18 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

## Kreditë jo-performuese

### KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qer-16
Vlera e kredive jo-performuese	86.1	96.8	132.3	157.1	154.4	125.2	115.2
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%	119.9%

Tab. 22 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

### KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Qer-16
Kreditë jo-performuese (%)	5.90%	5.80%	7.50%	8.70%	8.30%	6.20%	5.3%
NPL rritja/zvogëlimi (%)	51.70%	12.50%	36.60%	18.80%	-1.70%	-18.90%	-8.0%
Përqindja e rritjes kreditore	13.20%	16.40%	3.80%	2.40%	4.20%	7.30%	7.6%

Tab. 23 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore




Fig. 19 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

## Referencat

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, gusht 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, qershor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, gusht 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, gusht 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, gusht 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë, gusht 2016, <http://www.fsdk.org/>;

Komiteti i Bazelit për Mbikqyrjen Bankare dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Siguruesve të Depozitave, Principet Themelore për Sistemet Efektive të Sigurimit të Depozitave, nëntor 2014, <http://www.iadi.org/en/assets/File/Core%20Principles/cprevised2014nov.pdf>;

Parlamenti dhe Këshilli Evropian, Direktiva 2014/49/EU mbi Skemën e Garantimit të Depozitave, prill 2014, <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0049&from=EN>;

## **PJESA III**

# **LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE DHE EKONOMIA QË SHËNUAN MUAJIN GUSHT**

## BANKA RAIFFEISEN NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN E GARANCISË ME FKGK



Prishtinë, 10 gusht 2016 - Banka Raiffeisen në Kosovë sot nënshkroi marrëveshjen e garancisë me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), gjë që i mundëson bankës të përfitojë më shumë siguri kolaterali për kreditë e lëshuara për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) të regjistruara në Kosovë. Kjo marrëveshje do të ofrojë qasje më të lehtë në financa për kompanitë kosovare.

Marrëveshja synon të zgjerojë kredihënien për bizneset kosovare, të kontribuojë në krijimin e

vendeve të punës, rritjen ekonomike, si dhe në rritjen e mundësive për sektorë ekonomikë e kategori që janë shërbyer më pak, si gratë, pakicat, bujqit, ndërmarrësit dhe rinia. Kreditë - për të cilat jepen garanci - do të lëshohen për plotësimin e nevojave të ndërmarrjeve për kapital pune dhe implementim të planeve/projekteve investuese. Cila është procedura për të përfitur nga ky fond? Bizneset aplikojnë për kredi në bankë si më parë, duke kaluar të gjitha procedurat e bankës. Nëse vlera e hipotekës/kolateralit të kredimarrësit të ardhshëm nuk është e mjaftueshme, apo kushtet tjera nuk plotësohen, banka mund të vendosë që ta kualifikojë biznesin dhe ta lëshojë atë kredi, duke shfrytëzuar garancinë e FKGK-së. Bizneset nuk mund të aplikojnë tek FKGK-ja që të marrin garancinë. Ceremonia e nënshkrimit u mbajt në zyrat e FKGK-së, në rrugën Anton Çetta nr. 5A, në Prishtinë.

## BPB NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN E GARANCISË ME FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE (FKGK)



Sot me datë 24 gusht 2016 në zyrat e FKGK, Banka për Biznes realizoj nënshkrimin e marrëveshjes së garancisë me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore. Garancia e FKGK-së i mundëson bankës rritjen e kredihënies për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë dhe si rrjedhojë do t'ju lehtësoj çasjen në financa të gjitha NMVM të cilat kanë nevojë për kredi për të plotësuar nevojat për investime për rritjen e biznesit të tyre apo për kapital punës. Përmes kësaj marrëveshje BPB do

të përfitojë më shumë siguri kolaterali për kreditë e lëshuara për këto ndërmarrje.

Marrëveshja e realizuar reflekton një bashkëpunim nga e cila përfitues janë bizneset kosovare të cilat janë faktorë mjaftë i rëndësishëm për ekonominë e vendit. Duke i financuar këto biznese ne do të ndihmojmë jo vetëm rritjen në këtë sektor, por edhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Zhvillimi i këtyre bizneseve do të ndikoj në rritjen e numrit të të punësuarve si dhe në krijimin e bizneseve më të mëdha të cilat do të rezultojnë në zhvillimin e regjionit. Procedura për të aplikuar për garanci:

Të gjitha bizneset aplikojnë për kredi me procedura standarde të bankes. Në rastet kur klienti nuk i plotëson të gjitha kushtet e kredimarrjes siç janë, vlera e kolateralit, hipoteka apo kushtet tjera banka do t'ja mundësoj lëshimin e kredisë duke shfrytëzuar garancinë e FKGK-së.

Bizneset nuk kanë të drejtë të aplikojnë direkt në FKGK për garanci.



## KOSOVA IMPORTON ME 2.6 MILIARDË, EKSPORTON ME VETËM 325 MILIONË EURO



Me gjithë përpjekjet e autoriteteve kompetente për mbështetje të sektorit privat, por edhe marrëveshjeve

të nënshkruara me vendet e Bashkimit Evropian për lehtësime tregtare, tregu i Kosovës vazhdon të dominohet nga prodhimet e huaja. Sipas shifrave zyrtare, vlera e importeve në Kosovë, në vitin 2015, ka arritur në 2.6 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 për qind. Kurse, vlera e eksportit të produkteve të Kosovës në vende të ndryshme të Evropës dhe botës ka arritur në vlerën 325.3 milionë euro, që përkon me një rritje të dobët vjetore prej 0.2 për qind. (Telegrafi, 1 gusht 2016)

## KOSOVARËT KANË RRETH 204 MIJË KARTELA KREDITI



Me gjithë përpjekjet e autoriteteve kompetente për mbështetje të sektorit privat, por edhe marrëveshjeve

të nënshkruara me vendet e Bashkimit Evropian për lehtësime tregtare, tregu i Kosovës vazhdon të dominohet nga prodhimet e huaja. Sipas shifrave zyrtare, vlera e importeve në Kosovë, në vitin 2015, ka arritur në 2.6 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 për qind. Kurse, vlera e eksportit të produkteve të Kosovës në vende të ndryshme të Evropës dhe botës ka arritur në vlerën 325.3 milionë euro, që përkon me një rritje të dobët vjetore prej 0.2 për qind. (Telegrafi, 1 gusht 2016)

## DIASPORA, 752 MILIONË EURO REMITENCA



Bashkëatdhetarët tanë që jetojnë në shtete të ndryshme të botës, gjatë vitit që lamë pas dërguan në Kosovë hiç më pak se 752 milionë euro. Në raport me vitin paraprak ka një rritje të dërgesave prej 8.5%. Por, shumica e mjeteve që realisht kanë ardhur nga diaspora në Kosovë llogaritet të jetë shumë më e lartë, pasi që një pjesë të madhe të mjeteve që ata i sjellin vetë në Kosovë nuk i deklarojnë farë gjatë hyrjeve nëpër pikat kufitare. (Zëri, 4 gusht 2016)

## RRITET VLERA E MJETEVE TË KONTRIBUESVE PENSIONALË




Kryesuesi i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale, Ymer Havolli, ka thënë se prej themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës e deri më 16 gusht 2016, kthimi bruto nga investimet është rreth 304 milionë euro. "Përmbi 300 milionë euro është shtuar vlera e mjeteve të kontribuuesve pensionalë nga investimi i tyre në tragjet financiare", ka deklaruar Havolli për "Epokën e re". (Epoka e Re, 23 gusht 2016)

# PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“Periodiku Bankar” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.  
[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com).







# Qendra për Trajnime Bankare

## TRAJNIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2016:

Certifikimi Ndërkombëtar EFCB

Bazat e Pajtueshmërisë

Lidershipi dhe formimi i Ekipeve

Menaxhimi i Riskut Operacional

Menaxhimi i Porfolios së Riskut Kreditor

IFRS

Nga Zyrtar i TI në Auditor të TI

Mbikëqyrja e Stafit

Mirësjellja në Biznes



Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171

[kbtraining@bankassoc-kos.com](mailto:kbtraining@bankassoc-kos.com)



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION